

# TRUSTORJA

## KRYETITUJT E KËTIJ NUMRI

- \* Investimet: €10 mln në TM1 (faqe 2)
- \* Drejt Strategjisë së re Investuese (faqe 3)
- \* 29% rritet nr. i eTrusti-llogarive (faqe 3)
- \* Nr. i shërbimeve në TM1: 19,873 (faqe 4)

## FAKTET KRYESORE

Më 31 mars 2014

Çmimi i aksionit	€1.2231
Mjete nën menaxhim	€948,271,784.21
Pensione të shpaguara në tremujor	€3.8 mln
Llogari të kontribuuesve	453,516
Aksione të emetuara	775,315,149.93

## INVESTIMET


### Çmimi i aksionit:

Janar	-1.03%
Shkurt	1.90%
Mars	0.09%
Gjithsej performanca neto	0.94%

### Kthimi bruto:


Janar	€-9.10 mln
Shkurt	€17.78 mln
Mars	€1.31 mln
Gjithsej kthimi bruto	€9.99 mln

## PERFORMANCA KUMULATIVE E FKPK-SË NGA THEMELIMI



Periudha	1 muaj	3 muaj	Ky vit	1 vit	5 vjet	Nga themelimi
Rezultati	0.09%	0.94%	0.94%	4.97%	50.25%	22.31%

## PLASMANI I MJETEVE NË FUND TË TREMUJORIT



## PERFORMANCA E FONDEVE INVESTUESE DHE LV KOSOVË NË TREMUJOR

1. VANGUARD	▲ +0.85%	4. AXA GILB	▲ +2.78%	7. LV - KOSOVË	▲ +0.38%
2. SCHRODERS	▲ +1.84%	5. BNY MELLON	▲ +1.24%		
3. ECM-DEC	▲ +1.71%	6. ALCEDA	▲ +2.88%		

BOTUES: Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës - Botuar: maj 2014

Autor: Jeton Demi

Kontakt: Rr. "Agim Ramadani" Nr. 10, 10000 Prishtinë - 038-244-341 - info@trusti.org - www.trusti.org

## €10 MLN NGA INVESTIMET NË TM1

Kthimi bruto nga investimet e FKPK-së në tremujorin e parë (TM1) të 2014-s ishte gati €10 mln. Në fund të TM1 çmimi i aksionit arriti në €1.2231, i rritur për 0.94% nga €1.2117 sa ishte në fund të 2013-s. Në ndërkohë, mjetet nën menaxhim për këtë periudhë u rritën për rreth €35 mln, dhe arritën në €948 mln. Rritja e mjeteve nën menaxhim, përveç prej kthimit nga investimet (€10 mln), u ndikua edhe nga kontributet të reja që për TM1 ishin €30.2 mln. Në anën tjetër FKPK shpagoi pensione prej €3.8 mln, ndali për tarifën menaxhuese €1.2 mln dhe refondoi €0.03 mln.

### Faktorët me ndikim

Megjithëse në përqindje ky kthim është relativisht modest, 0.94%, ambienti ekonomik global e përligj atë. Problemet me zhvillimin e ekonomisë aziatike dhe performanca negative për këtë tremujor e tregut të kapitalit në dy qendrat kryesore, Kinë e Japoni, bashkë me tensionin e krijuar në Ukrainë mes SHBA-ve dhe Rusisë, dhe potencialit të madh që bartte ky tension ndaj ekonomisë globale, ishin frikësues e frenues për investitorët. Ky tremujor në përgjithësi vlerësohet si “i ftohtë” krahasuar me performancën e tremujorit paraparak, dhe vetëm masat stimuluese monetare që vazhduan në SHBA, dhe u paralajmëruan edhe në BE e Azi, ishin faktorë nxitës. Përkundër faktit se ekonomitë e zhvilluara të globit po japin shenja të stabilitetit dhe rritjes ekonomike, performanca negative e tregjeve në zhvillim po e pengon ekuilibrimin e tregjeve financiare globale.

Investimet e FKPK-së në janar rezultuan me performancën negative prej -1.03%, kryesisht nën ndikimin e pasigurisë së ekonomive kryesore aziatike. Shkurti solli rikuperim dhe rritje të performancës së investimeve me 1.90%, që ishte rezultat i politikave stimuluese në Japoni e Evropë. Rezultati mund të ishte edhe më i lartë sikur kriza e Ukrainës të mos shfaqej në horizont. Marsi u përmbyll me 0.09%, një vlerë pozitive që u arrit vetëm në ditët e fundit të marsit, kur kriza në Ukrainë dha shenja të një qetësie momentale.

# 0.94%

Kthimi nga investimet në TM1

### Performanca e menaxhuesve të mjeteve

Ky tremujor ishte më specifik për performancën e menaxhuesve të mjeteve të FKPK-së. Të gjithë menaxherët e mbyllën tremujorin në performancë pozitive, dhe rezultati financiar në vlerë i kthimit nga investimet si rrallë nuk dallonte shumë mes portofoleve investuese. Ky ishte rezultat i kryesisht pas performancës pozitive të gjitha instrumenteve financiare në tregjet e shteteve të zhvilluara, ku edhe janë të përqendruara investimet e FKPK-së.

Megjithatë, edhe për këtë tremujor kontribuuesi kryesor i kthimit nga investimet ishte portofoli investues i përqendruar në aksione, i menaxhuar nga Vanguard, i cili përfitoi nga vazhdimi i rritjes së tregjeve në vendet e zhvilluara. Afër kësaj performace ishte edhe portofoli i BNY Mellon, i shpërndarë globalisht në shumicë në aksione, e më pak në fletobligacione të shteteve dhe korporatave, në instrumente të konvertueshme e para të gatshme e të tjera. Jo shumë larg ishin edhe performancat e Schroders, i përqendruar në bono, dhe AXA-s, në bono globale që ndjekin inflacionin. Portofoli i Alceda-s, i përqendruar në bonot e Evropës, që synon balancimin e riskut mes klasave të aseteve, dhe ai i ECM-së, në tregun e kredive të Evropës, simbolikisht ishin në territorin pozitiv të performancës, të ndikuara ndjeshëm nga pasiguria që vazhdon të ekzistojë në eurozonë. Letrat me Vlerë të Kosovës janë me normë interesi të paracaktuar dhe ky investim si i tillë nuk varet nga faktorë të jashtëm që mund të ndikojnë në kthim.

**Tabela 1:** Performanca investuese në TM1 2014 dhe plasmanet investuese në fund të tremujorit

Menaxhuesi/ Entiteti	Klasa e investimeve	Plasmanet (në euro)	Kthimi bruto (në euro)
Vanguard	Aksione	316,204,394.91	2,864,145.77
BNY Mellon	Kthim absolut	135,384,246.25	2,244,651.99
Schroders	Bono	98,149,981.58	1,770,137.70
AXA	Bono globale të lidhura me inflacionin	59,082,867.97	1,653,302.33
Alceda	Kthim absolut	27,764,878.28	778,248.68
ECM	Tregu i kredive	23,802,458.68	428,232.42
Letra me Vlerë të Kosovës	Bono thesari	62,797,294.33	248,234.30
	<b>Gjithsej</b>	<b>723,186,122.00</b>	<b>9,986,953.19</b>

## FKPK DREJT POLITIKËS SË RE INVESTUESE

Përkundër faktit se Politika Investuese në fuqi është dëshmuar si shumë e suksesshme, meqë rritja e çmimit të aksionit ishte 40.8% qysh prej përvetësimit të saj më 2009; shtimi i pasigurisë në botë nga niveli i lartë i borxheve nacionale, rritjes së ngadalësimit të rritjes së tregjeve në zhvillim, e ka shtyrë Bordin që të pranojë nevojën për të evoluar, dhe për të vendosur parime dhe politika të reja investuese, që pritet të shërbejnë së paku për pesë vjetët e ardhshëm. Për këtë Bordi Drejtues i FKPK-së, i ndihmuar edhe nga Menaxhmenti, gjatë TM1 ka kryer pjesën më të madhe të procesit të ndryshimit të strategjisë investuese. Kalimi në Politikën e re Investuese do të bëjë që të lëvizin €280 mln drejt fondeve të menaxhuesve të rinj të përzgjedhur të investimeve. Nga këto mbi €200 mln do të financohen nga mjetet e pa-investuara në BQK dhe pjesa tjetër nga zvogëlimi i mjeteve në portofolet aktuale investuese.

Duke qenë se objektivi kryesor i investimeve të FKPK-së në afatgjatë është që, së pari të ruajë dhe së dyti të rrisë kapitalin e kontribuuesve, në terma nominalë dhe ata realë,

## RRITET PËR 29% NUMRI I PËRDORUESVE TË eTRUSTI-T

Numri i përdoruesve të shërbimit elektronik eTrusti u rrit për 29% gjatë këtij tremujori. Nga 23,865 përdorues që ishin në fund të 2013-s për këta tre muaj numri i tyre ka arritur në 30,712 përdorues. Shtimi i numrit të përdoruesve të eTrusti-t, që FKPK-ja e ofron qysh prej pesë vjetësh, duket se është ndikuar shumë nga fushata e fundit informuese përmes televizionit që FKPK-ja e ndërmori në këtë periudhë. Megjithatë, veç kësaj, në dy

# €280 mln

Mjetet që do të lëvizin nga ndryshimi i strategjisë investuese

Deklarata e re e Parimeve Investuese të Bordit e ka vendosur Indeksin e Çmimeve të Konsumit në Kosovë si bençmark kundrejt së cilit do të matet performanca e investimeve të FKPK-së. Udhëzuesi i ri i Politikave Investuese (UPI) e njeh faktin se asnjë portofolio investuese nuk mund të arrijë kthim pa ndërmarrë një dozë të caktuar të riskut të tregut (financiar), dhe se asnjë portofol nuk mund të izolohet plotësisht ose pjesërisht nga risqet e tregut. UPI-ja e re, duke e pranuar që duhet të ketë një ekuilibër mes kontribuuesve që janë afër pensionimit dhe atyre që nuk janë, bën thirrje për një politikë e cila përmban një masë të arsyeshme por jo të tepruar të alokimit në mjete afatgjatë nga të cilat pritet kthim dhe luhatshmëri me e lartë, të tilla si aksionet; e kombinuar me një alokim më të madh në investime nga të cilat pritet luhatshmëri më e vogël sesa tek aksionet dhe kthime më stabile. Manualin e Investimeve të plotë mund ta lexoni në: [http://trusti.org/Dokumentet/Shqip/SIP\\_20131213\\_shq.pdf](http://trusti.org/Dokumentet/Shqip/SIP_20131213_shq.pdf).

vjetët e fundit ka një shtim të vazhdueshëm të interesit të kontribuuesve për t'u informuar për llogarinë e tyre. Ndhimë të madhe në këtë aspekt ka dhënë penetrimi i teknologjisë së telefonave të mençur, të cilët u ofrojnë mundësinë përdoruesve që të bëjnë foto të dokumenteve verifikuese (ID, pasaportë, patentë-shofer) dhe t'i dërgojnë ato për verifikim të identitetit në FKPK shumë më lehtë sesa më parë.

## PUBLIKOHET RAPORTI VJETOR DHE PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN 2013

FKPK-ja i ka përgatitur Raportin Vjetor dhe Pasqyrat Financiare për vitin 2013 dhe të njëjtat mund të vizitohen përmes vegëzës: <http://trusti.org/index.php/sq/raportet>. Raporti Vjetor 2013 ka pësuar ndryshime të mëdha si në aspektin vizual ashtu edhe në atë përmbajtësor krahasuar me vitet e kaluara. Megjithatë aty do të mund të gjenden të gjitha të dhënat kryesore për aktivitetin e FKPK-së gjatë 2013-s dhe krahasimet me vitet paraprake. Bashkë me Raportin Vjetor janë publikuar edhe Pasqyrat Financiare, të ndara

sipas Operacioneve dhe Mjeteve Pensionale, të cilat përgatiten sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Tek Pasqyrat Financiare është shprehur edhe opinioni i auditorit të jashtëm profesional, në të cilin edhe këtë vit FKPK-ja ka marrë opinion të pastër. Një opinion i tillë vlerëson se të gjitha të dhënat financiare të FKPK-së janë prezantuar drejt, e nuk përmbajnë deklarata materialisht të gabuara, qoftë për shkak të gabimit qoftë për shkak të mashtrimit.

## 19,873 SHËRBIME TË OFRUARA KËTË TREMUJOR

Zyrtarët e marrëdhënies me klientët të FKPK-së i kanë ofruar 19,873 shërbime klientëve gjatë TM1. Shtypja e pasqyrave të llogarive individuale vazhdon të jetë aktiviteti më i kërkuar nga kontribuuesit, duke zënë rreth 48% të shërbimeve të ofruara. Më pas vije aktivizimi i llogarive online, pra eTrusti, me 25% dhe përditësimi i adresave dhe aplikimi për pension me përkatësisht 9% dhe 5%. Shërbimet e miratimit të kërkesave për pensionim, përgjigja në pyetjet e dërguara në uebmail dhe kontaktimi i punëdhënësve zënë së bashku

pjesën tjetër të shërbimeve. Krahasuar me vitin e shkuar ka një rritje të dukshme të shërbimeve të ofruara. Për vitin 2013 ishin ofruar gjithsej 49,486 shërbime, ose 198 shërbime për ditë pune, ndërsa për TM1 janë ofruar mesatarisht 331 shërbime për ditë pune. Sipas këtij raporti numri i shërbimeve për ditë është rritur për 67% krahasuar me vitin e shkuar. Megjithatë duhet pasur parasysh edhe faktin se TM1 është periudha kur kontribuuesit zakonisht kërkojnë më shumë shërbime sesa pjesën tjetër të vitit.

## €62.8 MLN TË INVESTUARA NË LVK

Investimet e FKPK-së në Letrat me Vlerë të Qeverisë së Kosovës (LVK) ishin në vlerën e €62.8 mln në fund të TM1, nga €53 mln sa ishin në tremujorin paraprak, që i bie një rritje prej 18%. Investime të reja në LVK gjatë këtij tremujori ishin €21.2 mln, ndërsa të maturuara ishin €11.6 mln. Në fund të TM1 FKPK-ja i kishte të shpërndara këto mjete në pesë ankande të Qeverisë, dhe maksimumi i investimit ishte €17.8 mln dhe minimumi €3.4 mln. Investimet në LVK ishin sa 6.6% e mjeteve nën menaxhim, dhe sa 8.7% e mjeteve të investuara.

Sa i përket investimeve në tregjet financiare globale

# €62.8 mln

Investimet në LVK

FKPK-ja nuk ndërmori investime të reja, duke qenë në pritje të përmbylljes së përzgjedhjes së fondeve të hapura investuese si pjesë e Politikës së re Investuese. I vetmi, kushtimisht, investim ishte ai i rabatave të menaxhuesve Vanguard dhe AXA, në total prej 96 mijë euro.

## €3.8 MLN PENSIONE TË SHPAGUARA

Gjatë TM1 vlera që i është kaluar në llogaritë bankare përfituesve të pensionit arriti në €3.8 mln. 79% e kësaj vlere iu shpague përfituesve të pensionit të moshës (ose 803 të pensionuarve), 19% të saj e tërhoqën trashëgimtarët e 242 kontribuuesve të vdekur, dhe 2% shkoi tek përfituesit e pensionit të invaliditetit (ose 41 përfitues). Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë (TM1 2013) vlera e pensionit të shpague është rritur për 31%, nga €2.9 mln.

Ndryshe nga kjo, numri i përfituesve ka rënë në 1,084, ose 44% krahasuar me 1,919 sa ishin në TM1 2013. Kjo shpjegohet me faktin se para një viti kontribuuesit kishin më pak kontribute sesa tani, e gjithashtu çmimi i njësisë në fund të këtij tremujori ishte për 5% më i lartë se një vit më parë.

## PËRFUNDON SHPËRNDARJA E PASQYRAVE INDIVIDUALE TË LLOGARIVE

Posta e Kosovës e ka njoftuar FKPK-në se më 20 mars 2014 ka përfunduar shpërndarja e pasqyrave individuale të llogarive tek kontribuuesit. Sipas raporti të Postës, 92.09% e pasqyrave është arritur të shpërndahen (ose 379,971), ndërsa pjesa tjetër, 32,557 sosh, nuk janë shpërndarë. Arsye kryesore për mosshpërndarjen e 7.91% të pasqyrave ishin adresat jo të plota në shënimet e FKPK-së për këta kontribuues. FKPK përkujton të gjithë kontribuuesit që nuk e

pranojnë pasqyrën të interesohen për këtë duke kontaktuar FKPK-në me e-mail ose telefon. Po me zarfin e dërguar pasqyra, FKPK-ja ua ka dërguar këtë vit të gjithë kontribuuesve një pyetësor përmes të cilit synohet të kuptohet perceptimi dhe vlerësimi i tyre për FKPK-në dhe shërbimet e saj. Përkundër faktit se dërgimi i pyetësorit ka qenë falas, vetëm një numër simbolik i pyetësorëve deri më tani kanë arritur në FKPK përmes Postës së Kosovës.